

# Rregullorja M1802 e WWW faqes dhe e mediave sociale te Shoqatës Bashkimi

**09.01.2018**

1. Faqja zyrtare e shoqatës Bashkimi është [www.bashkimi.fi](http://www.bashkimi.fi)
2. Faqja zyrtare e Facebookut quhet Shoqata Bashkimi. URL i kësaj faqeje është <https://www.facebook.com/Shoqata-Bashkimi-291110267713450/>
3. Shoqata Bashkimi nuk ka faqe tjera ne rrjetet tjera sociale (p.sh, Twitter, Google+). Hapja e tyre behet me pëlqimin e kryesisë së shoqatës.
4. Administrator të Web faqes dhe faqes (faqeve) tjera ne rrjetin social janë aktivistë të shoqatës të cilët kanë pranuar kushtet e kësaj rregullore dhe kanë nënshkruar atë.
5. Administratoret e faqeve te shoqatës zgjidhen nga kryesia e shoqatës.
6. Postimi ne faqet e shoqatës nuk lejohen të këtë pikëpamje politike, pornografike fyese apo përmbajtje tjetër qe nxitë urrejtje ose dhunë në mes të grupeve religjioze ose etnike.
7. Të drejtat e administratorit të shoqatës i hiqen aktivistit nëse ky i fundit bën shkeljen e kësaj rregullore.
8. Administratori i faqeve ka të drejt të largohet nga administrimi i faqeve të shoqatës duke informuar kryetarin e shoqatës në mënyrë elektronike (email) apo SMS.
9. Të gjitha të drejtat e autorit ( © Copyright) të kodeve, fotove, videove, e punimeve të tjerë të postuara apo publikuara në faqet e shoqatës i mbesin Shoqates Bashkimi. Administratori i shoqatës në largim nuk ka të drejtë të bënë fshirjen e tyre.
10. Kjo rregullore ndryshohet me pëlqimin e shumicës së kryesisë të shoqatës.